



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 942/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e Fiknete Bejta, anëtare për Kuvendin Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Fiknete Bejta, anëtare për Kuvendin Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, me shenjën ZL.Anr.942/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.942/2017 me datën 10.11.2017, nga Fiknete Bejta, anëtare për Kuvendin Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë në të cilin pretendon se i mungojnë votat të cilat i ka marrë nga familjaret e saj në vendvotimet 1933E/01R; 1933E/02D; 1927E/04R; 1927E/05R .

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesja e apelit nuk e specifikon se sa vota i mungojnë dhe nuk e ka dëshmuar me asnjë provë krahasueshmërinë e votave për të cilat pretendon se i mungojnë.

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara për shkak të mungesës së dëshmive lidhur me pretendimet e parashtruara në apel dhe se të njëjtat nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 10.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete lidhur me pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pa argumentuar me fakte dhe si i tillë është i pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.942/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuese e Panelit
Gyltenë Sylejmani



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*